

Atraksionet turistike në Komunën e Pejës

Nr.	Emertimi	Pershkrimi i atraksionit	Kategoria	Adresa	Komuna
1	Muzeu i Pejës	Muzeu i Pejës ka një rëndësi mjaft të madhë për komunën e Pejës pasi që në të janë të prezantuara shumë artefakte të cilat ruhen dhe prezantojn vlerat kulturo historike të Pejës që nga kohrat Ilire e deri në ditët e sotme. Përveq ekspezitës së brendshme muzeu ndodhet në një shtëpi të vjetër qytetare e cila gjithashtu shpreh vlera arkitektonike dhe prezanton një nga shtëpit e vjetra dhe të bukura të qytetit të Pejës.	Atraksion kulturor	Sheshi "Haxhi Zeka"	Pejë
2	Çarshia e Vjetër	Çarshinë e vjetër, është një kompleks i dyqaneve e cila paraqet një zonë me unike të trashëgimis kulturore dhe historike në Pejë. Çarshia e Vjetër është e njohur për rëndësinë e saj në zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e zejeve. Kjo zonë është ndërtuar gjatë kohës së Perandorisë Osmane në shek. XIV dhe përbëhet nga 4 pjesë (Çarshia e Madhe, Çarshia e Gjatë, Okoli dhe Çarshia e Shatervanit). Në atë kohë në këtë kompleks gjindeshin rreth 960 dyqane ku janë përpunuar zeje të ndryshme. Edhe sot, në Çarshi ende ekzistojnë disa nga këto dyqane të cilët shfrytëzohen për qëllime të njehta.	Atraksion kulturor	Çarshia e Gjatë	Pejë
3	Bajrakli Xhamia	Bajrakli xhamia (Çarshi xhamia) i takon periudhës Osmane të shekullit XV apo më në specifike kjo xhami u ndërtua në vitin 1471 nga Sulltan Fatih Mehmet Hani. Është një nga objektet më interesante të trashëgimis kulturore në Pejë. Ajo që e veçon këtë xhami është pjesa e brendshme e saj në të cilën gjinden punime arti të ndryshme në murret e saja. Gjindet në mes të kompleksit Çarshia e Gjatë andaj edhe në popull e gjeni me emrin Çarshi Xhamia. Në oborin e saj janë karakteristike varetat e vjetra e ndër to gjendet edhe varri i patriotve Haxhi Zekëa dhe Ali Pash Guçia. Siq u dogj në tërrësi Çarshija e vjetër edhe kjo xhami e pësoj tërësisht në djegja. Pas luftes u bë restaurimi i xhamisë në elemente arkitektonike po ashtu edhe në ato të pikturës e skulpturës nga organizata Italiane INTERSOS . Ndërsa ne vitin 2019-2020 është restauruar për herë të dytë nga organizata TIKA.	Atraksion kulturor	Çarshia e Gjate	Pejë
4	Hamami i Haxhi Beut	Hamami i Haxhi Beut i takon gjithashtu periudhës Osmane e ndërtuar në shekullin XV. Ka funksionuar si banjë publike e cila është përdorur edhe nga mashkujt edhe nga femrat. Tani është një monument i trashëgimis në Pejë dh efunksioni i mëparshëm nuk është i mundur. Është tentuar të shkatërohet shumë her nga oushtuesit serb por eshte mbrojtur gjithmon nga popullata e Pejës. Ky hamam një koh është shfrytëzuar si shtëpi kulture ku janë mbajtur ekspozita dhe aktivitete të ndryshme. Pas luftës është restauruar nga organizata Intersos. Ky objekt i trashëgimis është lënë pas dore dhe duhet urgjentisht të intervenohet në të dhe të bëhet funksional për aktivitete të ndryshme.	Atraksion kulturor	Pejë	Pejë

5	Hamam xhamia	Hamam Xhamia është ndërtuar rreth vitit 1587. Ajo gjendet në pjesën e vjetër të qytetit në lagjen e “Haxhi Zekës”, afër Hamamit të Haxhi beut dhe ndërtesës së Shkollës së parë shqipe në Pejë. Xhamia hyn në radhën e monumenteve të vjetra historike të trashëgimisë kulturore, jo vetëm për qytetin e Pejës por tërë Kosovës. Xhamia njihet me emrin Bulla Zade Hasan. Është djegur në vitin 1890, si dhe gjatë Luftës së Parë Botërore, dhe pas 5 viteve është rindërtuar. Në oborrin e xhamisë ekzistojnë një numër i varrezave të cilat i takojnë periudhave të ndryshme kohore. Sipërfaqja totale është 285 m2. Çardaku (hyrja) është shtuar më vonë. Xhamia ka pësuar transformime gjatë rindërtimit dhe nuk e ka pamjen fillestare. Objekti ambientohet me objektet përreth. Është djegur dhe gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1999. Kurse është restauruar gjatë vitit 2001.	Atraksion kulturor	Pejë	Pejë
6	Xhamia e Defterdarit	Xhamia e Teftedarit është një nder xhamit më të vjetra dhe më atraktive në qytetin e Pejës. Sikurse edhe xhamit tjera edhe kjo i takon periudhës osmane e ndërtuar në shekullin XV. Gjania është e ndërtuar nga guri. Ajo që e bënë më të veçantë këtë gxhami janë edhe varetat e vjetra që gjinden në oborin e kësaj xhamie. Sikurse edhe xhamit tjera edhe kjo është djegur në tërësi nga lufta dhe pastaj është resaturuar. Kjo xhami është futur në shtegun kulturor të Pejës dhe vizitohet gjatë gjithë vitit në vizitor të vendeve të ndryshme të botës,	Atraksion kulturor	Pejë	Pejë
7	Xhamia e Kurshumlis	Kurshumli Xhamia është xhamia më e bukur në qytet e ndërtuar gjatë pushtimit të Pejës nga Perandoria Osmane. Edhe kjo xhami i takon ndërtimit të shek XV. Gjania është e ndërtuar nga guri dhe ka një kopshtë shumë të bukur dhe me mirëmbajtje të mirë. Sikurse edhe xhamit tjera edhe kjo është djegur në tërësi nga lufta dhe pastaj është resaturuar. Kjo xhami është futur në shtegun kulturor të Pejës dhe vizitohet gjatë gjithë vitit në vizitor të vendeve të ndryshme të botës	Atraksion kulturor	Pejë	Pejë
8	Mulliri i Haxhi Zekës	Mulliri i Haxhi Zekës është mulliri i parë në rajon, teknologjia e të cilit është sjellë nga Austria. Nëse e vizitoni do të shihni prej ku ka filluar të zhillohej industria në rajon. Ja, prandaj është mirë mos ta lëshoni mundësinë . Mulliri i Haxhi Zekaës është kompleks i madh i trashëgimisë industriale i cili i takon pjesës së dytë të shekullit të 19-të. Është ndërtuar me ndihmën e austro-hungarezëve. Ndërtesa përbëhet nga mulliri dhe hambari. Për kohën në të cilën u ndërtua ishte objekti më i lartë i cili posedonte tre kate. Fasada është nga guri i kombinuar, tulla, dritare hark dhe korniza. Fillimisht mulliri ka punuar me ujë, pastaj është përdorur energjia elektrike. Aty ka filluar ekonomia industriale në Pejë. Në të kaluarën i gjithë regjioni ka kryer shërbimet e bluarjes së drithit dhe prodhimit të miellit. Pas vdekjes së Haxhi Zekës, udhëheqës u bë nipi i tij, Jashar Pasha. Në vitin 1997 u mor në mbrojtje nga shteti. Gjatë luftës së vitit 1998-1999, mulliri u dogj por u restaurua dy herë: në vitin 2004 pjesa e mullirit dhe në vitin 2016 pjesa e hambarit.	Atraksion kulturor	Pejë	Pejë
9	Kulla e Kahreman Agës	Kulla njihet me emrin Kulla e Kahreman Agës. Kjo kullë është një vepër arti e mjeshtërve shqipëtar që kanë punuar me gurë të gdhendur. Është ndër kullat më atraktive në qytetin e Pejës dhe është e futur gjithashtu në shtegun kulturor. Kjo kullë është prone private nën mbrojtje e IMM. Kulla u ndërtua në dekadën e fundit të shekullit të 19-të. Ndërkohë kulla ka pësuar disa ndryshime të vogla në ndërtimin arkitektonik në dritaret, d.m.th ato të katit të sipër dhe ato të brendshme. Kjo kullë mirëmbahet mjaft mirë dhe në të banon familja Limani sipronar të ndërtesës. Kulla mund të vizitohet vetëm nga jashtë.	Atraksion kulturor	Gen. Wesley Clark	Pejë

10	Kulla e Gockajve	Kulla e Gocka-ve është gjithashtu një ndër vlerat e trashëgimis kulturore dhe prezanton vlerat historike të Pejës. Është kullë 3 katëshe e cila është e ndërtuar me mjeshtri të madhë nga mjeshtrit shqipëtar dhe paraqet një arkitektur unike në ndërtimin e saj. Në këtë kullë është i vendosur Instituti rajonal për Mbrojtjen e Monumenteve kulturore historike andaj edhe qasja është e mundur në të. Gjithashtu edhe ky objekt është i përfshirë në shtegun kulturor të Pejës.	Atraksion kulturor	Pejë	Pejë
11	Kulla e Begollve	Kulla e Zenel Beut, është e njohur e njohur gjithashtu si Konaku i Zenel Beut në Pejë. Zenel Beut është një ndër personalitetet e njohura të familjes zëmadhe, patriotike dhe të pasur të Begollëve të Pejës. Si rilindas ishte në kontakt dhe bashkëpunonte me Haxhi Zekën, Ali Pashë Gucinë, Isa Boletinin, Idriz Seferin, Zejnullah Bej Vuçiternën, Aqif Pazqin etj. U angazhua në mënyrë aktive në përgatitjen e kuvendit të Lidhjes së Pejës e njohur me emërin “Besa Besë” në vitin 1899. Kjo kull i takon ndërtimeve të shekullit XIX si edhe kullat tjera. Kjo kullë ka një histori mjaft të rëndësishme pasi që nga okupatorët është tentuar gjatë gjithë kohës të humben gjurmët, të nacionalizohet dhe të përdoret për arsye të ndryshme. Tani kati i parë i kësaj kulle shërben si restorant ku vizitorët përveq ushqimeve tradicionale mund të kalojnë kohën duke përzjetuar ambientin e kësaj kulle.	Atraksion kulturor	Pejë	Pejë
12	Kisha Katolike	Është kisha kryesore në Pejë dhe kisha më e vjetër e cila është ndërtuar në vitin 1928 mbi themelet e kishës së vjetër të konfesionit katolik shqipëtar. Kisha është e tipit bazilik me 3 anijata. Ekziston që nga koncili i parë i Arbërit (viti 1703i udhëhequr nga Papa Klementi). Është një objekt i cili vlen të vizitohet pasi që prezanton kulturat e religjionit katolik dhe zhvillimin e komunës së Pejës në periudha të ndryshme.	Atraksion kulturor	Westley Clark	Pejë
13	Varezat AustroHungareze	Varrezat Austro-Hungareze janë varreza të hershme të viti 1900-1912. Thiren me këtë meër pasi që aty janë të varosura 500 trupa të ushtrive Austro-Hungarez të cilat kanë shërbyer aso kohe në Pejë	Atraksion kulturor	Pejë	Pejë
14	Patriarkana e Pejes	Monument i cili është nën mbrojtje të UNESCO është Patriarkana e Pejës e cila gjendet në hyrje të Grykës së Rugovës. Është një nga monumentet mjaft të rëndësishme të Pejës pasi që paraqet një kulturë që i përket religjionit ortodoks. Është e ndërtuar në shekullin 13-14.	Atraksion kulturor	Pejë	Pejë
15	Kulla e Ministerit	Është e njohur si kulla e Ministerit dhe paraqet një stil shumë unik të ndërtimit. Është e ndërtuar me tulla por njihet si kullë. Gjendet jashtë zonës së qytetit dhe për shkak të gjendjes së saj nuk është futur në shtegun kulturor në Pejë.	Atraksion kulturor	Pejë	Pejë
16	Kulla e Haxhi Zekes	Në afërsi të sheshit "Haxhi Zeka" gjendet Kulla e Pashës apo e njohur edhe si Kulla e Haxhi Zekës. Është nga kullat e veçuara pasi që ofron arkitekturë ndërtimi unike ku në muret e saj janë të gravuara punime karakteristike të mjeshtërve shqiptarë të asaj kohe si: luani, ylli i Davidit etj. Është ndërtuar në shekullin XVIII dhe XIX, e ndërtuar nga gurri dhe ka tri kate e ndërtuar.	Atraksion kulturor	Pejë	Pejë

17	Kulla e Haxhi Zekes	Kulla e Haxhi Zekës në fshatin Leshan të Pejës është ndërtim arkitektural me vlera kulturo-historike, e ndërtuar nga rilindësi i shquar Haxhi Zeka. Ndërtimi është realizuar në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Shërbeu për nevojat e familjes së Haxhi Zekës. Kulla ka dy kate (P+2) ku gërshetohen elementet e arkitekturës qytetare me atë fshatare. Kulla i takon variantit të kullave me dyshekllëk të gurit që del nga muri perimetral në formë anëcaku dhe atë në qoshk të pjesës juglindore. Karakteristikë e këtij ndërtimi është ballkoni që del nga muri perimetral i fasadës jugore dhe atë në katin e tretë. Në enterierin e kullës janë të ruajtura edhe elemente dekorative, si tavani zbukurues nga druri i gdhendur nga mjeshtër me përvojë shqiptarë. Si material në realizimin e këtij objekti janë përdorur tulla, gurë, dru, të lidhura me llaç gëlqereje. Kulla ka pasur transformime, ajo nuk e ruan gjendjen fillestare. Restaurimi i kullës u bë në vitin 2009.	Atraksion kulturor	Leshan	Pejë
18	Kisha në Kuqishtë	Është një objekt mjaft i rëndësishëm e sidomos për rajonin e malor të Rugovës që njohet edhe si rajoni i fundit të cilët u konvertuan në fen muslimane. Është e ndërtuar në vitin 2003 në temelet e kishës së vjetër. Në këtë kishë koh pas kohe mbahen mesha ndërsa vizigohet nga vizitr të ndryshëm të cilët vizitojn bjeshkët e Rugovës. Kjo kishë u bekua në 2005 nga peshkopi Mark Sopi (1938-2006) i cili ishte një pasardhës i dëshmorëve të Karadakut të periudhës 1846-1848 ai udhëhoqi kishën e Kosovës nga 1996 në 2006.	Atraksion kulturor	Kuqishtë/Rugovë	Pejë
19	Muzeu i Ibrahim Rugovës	Muzeu i Ibrahim Rugovës gjindet në fshatin Malaj në Rugovë. Është i vendosur në një kull tradicionale dhe përmban eksponate të ndryshme që e identifikojn liderin dhe presidentin e parë të Kosovës.	Atraksion kulturor	Malaj/Rugovë	Pejë
20	Shpella Mbretëreshes	Shpella e mbretëreshës është një konfiguracion e shkëmbor e cila gjindet në kilometrin e tretë në Grykën e Rugovës. Ka tregime të ndryshme për këtë shpellë por ajo që më së shumti qarkullon nga populli është se këtu ka banuar Mbetëresha Jerina. Është shumë atraktive pasi që në këtë pjesë gjindet një sistem që lidh 8 shpella të cilat shihet se kanë qenë të banuara dikur. Tani në këtë zonë është ndërtuar shtegu Via Ferrata dhe bëhen vizita të këtyre shpellave.	Atraksion kulturor	Gryka e Rugovës	Pejë
21	Stacioni i Trenit	Gjatë viteve 30 -të shekullit XX-të, filloi ndërtimi i hekurudhës Fushë Kosovë- Pejë. Kjo bëri të mundshme që me anë të lidhjes hekurudhore banoret e Dukagjinit të kenë qasje lehtësuese në kryeqytet dhe vendet e regjionit. Me qëllim të funksionalizimit të hekurudhës në këtë relacion, në Pejë u ndërtua Stacioni i Trenit. Stacioni u vendos në Lokacionin pranë rrugës kryesore, rrugë kjo e cila lidhë qytetin e Pejës me atë të Prishtinës. Më saktësisht në lagjen Kristal në Pejë. Projekti u realizua përgjatë viteve 1933-1934. Është tipik për stilin dhe llojin e objektit. Kemi të bëjmë me një ndërtesë imponante për nga forma të ngjashme me kullat. Rrishtazi është hy në mbrojtje të Trashëgemis Kulturore.	Atraksion kulturor	Pejë	Pejë
22	Gryka Rugovës	Është ndër atraksionet kryesore në Komunën e Pejës dhe përbënë potencial për zhvillimin e turizmit. Vlerësohet si një nga kanjonet më të bukura edhe në rajon. Duke i vlerësuar karakteristikat natyrore, speloologjike, biodiversitetin dhe pamjet panoramike është vlersuar si monument natyror dhe është nën mbrojtje që nga viti 1988.	Atraksion natyror	Rr. Ker Sadria Gryka e Rugovës	Pejë

23	Burimi i Drinit të Bardh dhe Ujëvara	Është ndër atraksionet kryesore në Komunën e Pejës dhe përbënë potencial për zhvillimin e turizmit. Vlerësohet si një nga burimet kryesore të Kosovës nga e cila krijohet edhe lumi Drini i Bardh. Njëherit ky burim krijon gjithashtu ujëvarën e cila veçohet për bukurinë e saj në Kosovë por edhe në rajon. Duke i vlerësuar karakteristikat natyrore, hidrologjike, speleologjike, biodiversitetin dhe pamjet panoramike është vlerësuar si monument natyror dhe është nën mbrojtje që nga viti 1983.	Atraksion natyror	Radavc	Pejë
24	Shpella Gryka e Madhe	Është radhitur ndër 10 shpellat më atraktive në Evropë e cila veçohet për kanale vertikale. Deri më tani është hulumtuar 16km kanale të cila kanë atraksione unike me stalagmite dhe stalagтите, ujvare, procka dhe liqej të vegjël. Janë duke u bërë ende hulumtime nga ekspert të speleologjis, bitanist, hidrolog etj nga vende të ndryshme të botës. Një pjesë e saj ofrohet për vizita.	Atraksion natyror	Rr. Ker Sadria Gryka e Rugovës	Pejë
25	Shpella e Radavcit	Gjithashtu është një nga atraksionet kryesore në ofertën e Pejës. Është e hapur gjatë gjithë vitit dhe ofron infrastrukturë mjaft të mirë për ta vizituar. Ka buluri të stalagmiteve dhe stalagmiteve si dhe bazene të ujrave.	Atraksion natyror	Radavc	Pejë
26	Liqeni Liqenatit	Një nga vlerat e bjeshkëve të Rugovës dhe një nga atraksionet natyrore e cila vizitohet gjatë gjithë vitit edhe në sezonin e verës e gjithashtu në sezonin e dimrit është Liqeni i Liqenatit i cili gjindet në lartësi prej 1860m. Përgjatë këtij atraksioni kalon shtegu ndërkufitar Majet e Ballkanit. Vlen të përmendet së në këtë liqe jeton edhe një gjallesë e formës së hardhucës që njihet me emrin Triton.	Atraksion natyror	Kuqishtë/Rugovë	Pejë
27	Liqeni Drelajve	Liqeni i Drelajve apo siq njihet ndryshe edhe liqeni i Vogël gjindet në pjesën qendrore të Bjeshkëve të Nemuna në territorin e komunës së Pejës në një lartësi prej 1800m. Është liqe i akullnajave dhe krijohet nga shkrirjet e borës dhe të reshurat atmosferike. Është i vendosur përgjatë shtegut Majat e Ballkanit dhe nga turistët është cilësuar ndër atraksionet që duhet të vizitohet gjatë qëndrimit në Pejë.	Atraksion natyror	Drelaj/Rugovë	Pejë
28	Lumi Lumbardhi	Atraksion mjaft i rëndësishëm për qytetin e Pejës është Lumi Lumbardhi i cili krijohet nga burimet nga pjesët e ndryshme të Rugovës. Rrjedha e saj nga Rugova deri në lidhjen me Dinin e Bardh arin gjatesin prej 56km ndersa pjesa më e bukur e këtij lumi gjindet në Grykën e Rugovës si dhe pjesën e qendrës së qytetit të Pejës. Tani në këtë lum ofrohet edhe oferta e lundrimit me Kajak	Atraksion natyror	Pejë	Pejë
29	Lumi Drini i Badhë	Drini i Bardh është një nga lumenjtë më të rëndësishëm të Kosovës. Gjithashtu radhitet ndër lumenjtë me gjatësi dhe vrullshmëri të mjaftueshme të ujit. Buron në Pejë, në zonën e Radavcit dhe rrjedha e saj kalon nga Gjakova dhe Prizreni për të arritur në Shqipëri.	Atraksion natyror	Pejë / Radavc	Pejë
30	Maja Guri Kuq	Maja e Gurit të Kuq është maja më e lartë në komunën e Pejës dhe gjindet në pjesën qendrore të bjeshkëve të Nemuna. Lartësia e saj është 2522m dhe radhitet ndër majet atraktive për tu pushtuar në të gjitha sezonat. Gjatë gjithë vitit bjeshkatar dhe alpinist realizojnë ngjitje dhe njëherit këtë majë e kanë vlerësuar si një nga majet më atraktive për aktivitetet e alpinizmit pasi që ofron variacion të ndryshme për pushtimin e saj.	Atraksion natyror	Bjeshka Lumbardhit	Pejë
31	Maja Hajles	Maja e Hajles gjindet në Veri-perëndim të Pejës, në rajonin malor të Rugovës dhe në përcakton kufirin me Malin e Zi andaj shpesh turistët kalojnë në njëri shtet në tjetrin përmes kësaj maje. Radhitet ndër majet që tejkalon lartësinë prej 2000m dhe është shumë atraktive për ta ngjitur. Lartësia e saj arrin 2403m. Vlenë të theksohet se në këtë zonë gjindet edhe lulja Ylli Alpin (Edelweisse).	Atraksion natyror	Maja Hajles	Pejë

32	Maja e Çfërles	Maja e Çfërles gjindet në Jug-perëndim të Pejës dhe radhitet ndërë majet që tejaklon kartësin prej 2000m dhe është shumë atraktive për ta ngjitur. Pushtimi në këtë maje mund të bëhet nga 3 anë pra nga Peja, nga Milishevcu dhe nga Bjeshka e Strelcit. Pika më e lartë arinë 2461m.	Atraksion natyror	Bjeshka Koproanikut	Pejë
33	Maja e Vjellakut	Është një nga majet atraktive në Pejë të cilën pothuajse gjatë gjithë vitit e pushtojnë bjeshkatar, alpinist dhe adhurues të natyrës. Gjindet në veri-perëndim të Pejës dhe njëherit pamja e saj madhështore mund të shihet edhe nga qyteti i Pejës. Lartësia e saj është 2014 m	Atraksion natyror	Peklenë	Pejë
34	Maja e Hasanit	Është një nga majet atraktive në Pejë të cilën pothuajse gjatë gjithë vitit e pushtojnë bjeshkatar, alpinist dhe adhurues të natyrës. Gjindet në veri-perëndim të Pejës dhe njëherit pamja e saj madhështore mund të shihet edhe nga qyteti i Pejës. Lartësia e saj është 1900m. Vlenë të theksohet se në këtë zonë gjindet edhe lulja Ylli Alpin (Edelëisse).	Atraksion natyror	Llazë - Bellopaq	Pejë
35	Gubavci	Gjindet në pjesën Jug-perëndim të Pejës në pjesën malore të Koproanikut. Për shkak të rëndësisë botanike në të cilën jeton lloji endemo-relikt boshtra (Forsythia europeae) është vënë nën mbrojtje që nga viti 1959. Është zonë e rëndësishme për Pejë pasi që kalojnë shtigjet lokale dhe rajonale që lidh komunë të Pejës me atë të Deçanit si dhe ato ndërkufitare.	Atraksion natyror	Koproanik	Pejë
36	Shpella e Demajve	Shpella e Demajve e cila paraqet një formacion të krijuar në shkëmbinjë dikur ka qenë e banueshme andaj edhe i ka karakteristikat e saja të cilat prezantojnë një zhvillim shumë të hershëm të Pejës. Për këtë edhe është futur në listën e trashëgimisë natyrore të propozuar për mbrojtje.	Atraksion natyror	Te shara	Pejë
37	Parku Karagaq	Është parku më i madh në Pejë dhe ka një pamje që shfaqet edhe në foto për shkak të biodiversitetit dhe shumëllojshmërisë së florës. Gjithashtu ka një shumëllojshmëri të faunës si zogjë të ndryshëm dhe këtra. Pothuaj se në cdo stinë ky park është unikë për nga pamjet dhe ngjyrat e natyrës andaj edhe vizitohet mjaft nga turistët. Ky park shfrytëzohet shumë edhe nga banorët e Pejës për rekreacion dhe kohën e lirë. Sipas fjalëve të banorve ky park është projektuar në vitet e 70'ta nga një arkitekt Rus i cili i ka projektuar vetëm 3 parqe të këtij lloji në krejt Ish-Jugosllavin.	Atraksion natyror	Pejë	Pejë
38	Ujvara e zanave	Është një ujvarë shumë atraktive në të cilën është zhvilluar një shteg edukativ ambiental. Gjindet në treven malore të Rugovës dhe i takon fshatit Malaj por qasja në të bëhet duke ndjekur rrugën e fshatit Reka Allagës. Deri me tani shtegu është i zhvilluar deri në ujvarën e parë por është e nevojshme të vazhdohet më tutje.	Atraksion natyror	Reka Allagës / Rugovë	Pejë
39	ZIP LINE Marimangat	Zip Line është aktivitet rekreativ që ofron adrenalinë dhe përjetim të aventurave. Është ndërtuar nga organizatat Marimangat e Pejes në vitin 2016 dhe me përkrahje nga komuna e Pejës dhe Sëiss Contact. Ky aktivitet është një nga atraksionet që kërkohet mjaft nga turistët dhe njëherit ndikon mjaft në ngritjen e ofertës turistike të Pejës.	Atraksion natyror	Gryka Rugovës – KM 4	Pejë
40	Via Ferrata ARI	Via Ferrata Ari është hapur në vitin 2014. Është aktivitet i cili zhvillohet në pjesët shkëmbore të Grykës së Rugovës dhe është atraksion i aventurës e cila nxit interesimin e turistëve dhe sjell mjaft turistë në Pejë.	Atraksion natyror	Gryka Rugovës – Kilometri 3	Pejë
41	Via Ferrata MAT	Via Ferrata MAT është hapur në vitin 2015. Është aktivitet i cili zhvillohet në pjesët shkëmbore të Grykës së Rugovës dhe është atraksion i aventurës e cila nxit interesimin e turistëve dhe sjell mjaft turistë në Pejë.	Atraksion natyror	Gryka Rugovës – Kilometri 3	Pejë

42	Via ferrata Marimangat dhe Ura Tibetiane	Via Ferrata Marimangat dhe Ura Tibetiane është hapur në vitin 2018. Është aktiviteti i cili zhvillohet në pjesët shkëmbore të Grykës së Rugovës dhe është atraksion i aventurës e cila nxit interesimin e turistëve dhe sjell mjaft turistë në Pejë.	Atraksion natyror	Gryka Rugovë – Kilometri 6	Pejë
43	Shpella Bukuroshja e Fjetur	Është një nga atraksionet mjaft unike në Pejë e cila është hapur në vitin 2018. Shpella e Radavcës shquhet për bukurinë e saj dhe pasurinë me stalaktite dhe stalagmite dhe tani është e hapur të vizitueshme gjatë gjithë vitit.	Atraksion natyror	Radavcë	Pejë